



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 5 korrik 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivkoviq.

Munguan: Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Ardian Gjini dhe Ibrahim Makolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Natyra Krasniqi, Lumnije Murati - ZPRK dhe Fixhrije Dragaj-praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.6. 2011,
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete,
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrat të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009 dt. 19.4.2011,
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04 / L-012 për mbrojtje nga zjarri,
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut për sqarimin e nenit 11 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij,
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që si pika të rendit të ditës të radhitën edhe:

- Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/ L-011 për organizimin sindikal në Kosovë,
- Shqyrtimi i Raportit – informata e Avokatit të Popullit i ngarkuar me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit Nr. 04-P-038/k

Rendi ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6. 6. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 6. 6. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009 dt. 19.4.2011

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009 dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04 / L-012 për mbrojtje nga zjarri

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04 / L-012 për mbrojtje nga zjarri, dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për Mbrojtje nga Zjarri e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

U diskutua neni 2 i projektligjit dhe kishte diskutime lidhur me përfshirjen e komunitetit kroat në projektligj. Për këtë çështje diskutuan: Arben Gashi, Behar Selimi, Haki Demolli dhe Jasmina Zhivković dhe ishin të mendimit që projektligji është në pajtim me kushtetutën.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut për sqarimin e nenit 11 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij,

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim kërkesën e Komisionit për të Drejtat e Njeriut për sqarimin e nenit 11 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij. Me Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij është përcaktuar procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Në nenin 11, paragrafi 1(një), të rregullores se përmendur është përcaktuar se procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit zhvillohet në pajtim me nenin 3 (tre) të kësaj rregulloreje. Neni 3 (tre) e obligon Komisionin për të drejta të njeriut ta formojë panelin rekrutues, në të cilin përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare që e përbëjnë Komisionin. Paneli për të vepruar në pajtim me nenin 3 të rregullores, nuk e ka për detyrë t'i intervistojë kandidatët e paraqitur në konkurs për pozitat e zëvendësve të Avokatit të Popullit, por e ka për obligim ta shqyrtojë secilin aplikacion të kandidatëve të paraqitur në konkursin për pozitat e theksuara, për të konstatuar se janë plotësuar kushtet formale të parapara në konkurs. Veprimet e mëtejshme paneli i ndërmerr në pajtim me nenin 11 (njëmbëdhjetë), paragrafi 2 (dy) të rregullores.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përgjigjja e paraqitur nga Kryetari Komisionit i procedohet Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Personat e Pagjetur dhe peticione.

8. Të ndryshme

a) Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/ L-011 për organizimin sindikal në Kosovë

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/ L-011 për organizimin sindikal në Kosovë dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

b) Shqyrtimi i Raportit – informata e Avokatit të Popullit i ngarkuar me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-038/k

Kryetari- I njoftoi me përfundimin e kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-038/k dhe ishte i mendimit që ky raport duhet t'i procedohet Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Personat e Pagjetur dhe Peticione.

Armend Zemaj- Shprehu mendimin që kjo është pa përgjegjësi totale e Avokatit të Popullit, është një neglizhencë e tij dhe një mos efikasitet i detyrave që atij ia parashtron ligji për të mbuluar mos punën e tij edhe tendencat politike që i ka ai si Avokat i Popullit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Legjislacion vlerësoi së kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit, si dhe vendosi t'ia procedojë për shqyrtim të mëtejme Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

c) Njoftim lidhur me punën e grupit punues për P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve

Armend Zemaj- E informoi Komisionin se grupi punës pas dëgjimit publik me të gjitha rekomandimet që kanë kalë nga ky dëgjim ka bërë rreth 18- 19 amendamente dhe do t'i paraqiten Komisionit për shqyrtim dhe miratim. Ai, po ashtu, e njoftoi Komisionin se jemi duke punuar në rregulloren e punës të Kuvendit dhe herëve të tjera të koordinohet koha e mbajtjes së takimeve, në mënyrë që të mos jenë të njëjtën ditë në mbledhjet e Komisionit. Në vazhdim ai e informoi Komisionin se drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit i ka skaduar mandati dhe si Komision duhet ta diskutojmë këtë çështje në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi